



BPAL - Institucion i Edukimit Superior Universitar

PLAN-PROGRAM

Fakulteti Ekonomik

LËNDA:	Shoqëritë Tregtare	
Niveli i kursit:	Studime Bazike	
Lloji i kursit:	Zgjedhore	
Viti i studimeve	Viti III	
Semestri:	Semestri 6	
Kodi dhe shifra e lëndës:		
Koha/lokacioni:	Shih Orarin	
Ligjëratat:		
Ushtrimet:		
Mësimdhënësit e kursit:		e-mail / tel.:
	1. Prof.Ass. Dr.Jur. Korab R. Sejdiu	krriinvest@hotmail.com
	2.	
	3.	
	4.	

1. Përshkrimi i lëndës

Këtu theksohen çështjet/fushat kyçe që trajtohen në lëndën e cekur.

Qëllimi primar i lëndës është që t'i ofrojë studentëve një njohje të thellë të shoqërive tregtare dhe themelimit të tyre në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Konsideratë e veçantë do t'i jepet kuptimit të procedurave për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe detyrimeve feduciare.

Përqëndrimi kryesor do të jetë në zhvillimin e aftësive analitike të studentëve që t'i njohin dhe parashohin problemet juridike para se ato të paraqiten, me qëllim që t'ju shmangen atyre paraprakisht.

2. Qëllimet e lëndës

Çka synohet të arrihet nëpërmjet lëndës?

Shoqëritë Tregtare është një lëndë e rëndësishme për zhvillimin intelektual dhe profesional të studentëve. Tani më shumë se kurrë, kjo lëndë ka një rëndësi të veçantë sepse Kosova është duke kaluar nëpër një transformim juridik dhe ekonomik. Për atë arsye, kjo lëndë do t'i përgatisë studentet që t'i mësojnë rregullat ligjore të aplikueshme në Kosovë në pikëpamje të shoqërive tregtare. Të gjitha ato do t'ju mundësojnë studentëve një funksionim adekuat në një ambient juridik evolues.

3. Rezultatet e pritura

Dijet dhe shkathtësitë teorike dhe praktike që pritet të arrihen nga studentët.

Për hir të përgatitjes sa më të mirë, kërkohet nga studentët që të lexojnë paraprakisht materialet e shpërndara nga profesorët për temën që do të diskutohet në orën pasuese, për të krijuar një kuptim të përgjithshëm dhe njohje të materialit dhe temave që do të diskutohen në ligjërata. Studentët do të njoftohen rregullisht për materialet që duhen lexuar për orët pasuese. Studentët gjithashtu inkujarohen që të jenë aktiv në mësimin e lëndës dhe të interesohen në mënyrë të pavarur në kuptimin e lëndës dhe temave të mbuluara gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve.

Nëse studentët përcjellin këto këshilla, atëherë ata do të arrijnë rezultate të mira, siq janë:

- Kuptimi i natyrës së çështjeve juridike me të cilat ballafaqohen biznismenët kur themelojnë një shoqëri tregtare;
- Kuptimi i elementeve bazike të secilës shoqëri tregtare;
- Kuptimi i detyrimeve dhe përgjegjësiive të pronarëve dhe zyrtarëve të shoqërive tregtare.

4. Metodologjia

Metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret në instruktimin e programit të mëposhtëm bazohet në analizën e thellë të materialeve të përzgjedhura sipas udhëzimit të profesorit të lëndës.

Studentët duhet të ballafaqohen me problemet e jetës së përditshme të hulumtimit dhe interpretimit, të zgjedhura midis atyre më të shpeshta dhe tipike në proceset vendimmarrëse në fushën bizneso-juridike. Studentëve, pra, nuk do të analizojnë vetëm rregullat themelore në burimet e përshkruara, por problemet më të shpeshta që shfaqen gjatë aplikimit të tyre, për të ndriçuar strukturën e tyre dhe problemet interpretuese që lidhen me to.

Duke aplikuar metodën Sokratike – d.m.th. angazhimin e studenteve në ligjerimin e lëndës - do të bëhet, gjithashtu, *përpyetje* për një ekuilibrim të përhapjes së njohurisë mbi tiparet kryesore juridike dhe rritjes së aftësisë dhe kapacitetit për të zotëruar nocione më specifike dhe për të vepruar në kontekste më praktike.

5. Literatura

Sejdiu, Korab R., Doracak për Ligjin për Shoqëritë Tregtare, USAID EMSG (tetor 2008);

Ligji për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123 (pjesërisht)

Materiale shtesë

6. Punimet Kërkimore

TEMAT: Temat dhe udhëzimet për punime do t'ju shpërndahen studentëve së shpejti

PLAGJIATURA: Plagjiatura është vjedhje. Prandaj mos e bëni atë. Plagjiatura është përdorimi i ideve apo fjalëve të huaja pa i dhënë citim atij personi. Është e papranueshme që të pëdoren fjalët direkte nga një burim pa i futur ato në thonjëza dhe pa cituar burimin në fusnotë. Gjithashtu, është e palejuar që të merrni idenë apo idetë nga një burim pa e cituar burimin në fusnotë. Sanksionimi është i rreptë dhe plagjiatura e qëllimshme sado e vogël mund të rezultojë në mohimin e të drejtës për ta kaluar provimin në afatin përkatës.

REFERENCAT: Siq u cek në paragrafin paraprak, mbështetni pohimet and deklaratimet në punimet tuaja me referenca përkatëse. Kjo është e domosdoshme.

QARTËSIA: Keni kujdes që ta bëni të qartë tezën kryesore të punimit tuaj në pjesën hyrëse të përpilimit.

PËRQËNDRIMI: Qëndroni të përqëndruar në shkrim. Përpilimi i ideve tuaja duhet të vijon analitikisht dhe rrjedhmërisht.

DREJTSHKRIMI: Shëndërrimi i ideve në fjalë është një detyrë jo e lehtë. Prandaj, për ta arritur atë në mënyrë superiore kërkohet punë dhe redaktim. Së pari organizoni idetë që keni rreth punimit. Pastaj, bëni një përmbledhje të ideve, që vijon në mënyrë analitike. Përdorni titujt dhe nëntitujt që ta organizoni punimin në mënyrë të duhur. Kur të arrihet ajo, pastaj shkruani qartë, duke përdorur gjuhën e përsosur akademike dhe të biznesit. Fjalitë duhet të kenë kuptim, të jenë të shkurta dhe ti përcjellin rregullat gramatikore. Pas përfundimit të punimit, lexoni atë disa herë dhe redaktone.

8. Vlerësimet

Kollokfiumi nr. 1 Java 6

Kollokfiumi nr. 2 Java 11

Provimi Final: Të caktohet më vonë _____
DATA:

9. Politikat akademike dhe rregulloret e mirësjelljes

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Ata duhet të vijnë me kohë në mësim, të mbajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog në ligjërata. Gjatë kohës së mësimit studentët duhet t'i shkyçin telefonat celularë.

10. Metodatat e vlerësimit

Kollokfiumi nr. 1: 20%

Kollokfiumi nr. 2: 20%

Pjesëmarrja në Ushtrime dhe Ligjërata: 10%

Provimi Final: 50%
